



Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit të shërbimeve celulare

Dokument për Këshillim Publik

*(Miratuar me VKD nr.82, datë 1.10.2018)
Periudha e këshillimit publik nga data 2.10.2018 deri më 2.11.2018*

Tabela e Përmbajtjes

1. HYRJE	3
2. METODAT E RREGULLIMIT TE TARIFAVE DHE APLIKIMET E MËPARSHME NË SHQIPËRI	4
2.1. METODAT KRYESORE TË RREGULLIMIT TË TARIFAVE	4
2.2. RREGULLIMI I TARIFAVE ME PAKICË TË VODAFONE ALBANIA DHE AMC NË 2008-2010.....	5
2.3. RREGULLIMI I TARIFAVE TË TERMINIMIT NË RRJETET CELULARE	6
2.4. RREGULLIMI TARIFAVE TË AKSES ORIGJINIMIT NË RRJETET CELULARE 2010-2012.....	7
3. APLIKIMI I TESTIT MARGIN SQUEEZE NË VENDET E BE/BEREC	9
3.1. TESTI MARGIN SQUEEZE/ERT DHE REKOMANDIMI I KE	9
3.2. ZBATIMI I MS/ERT NË VENDET E BE/BEREC	12
3.3. RASTI I NORVEGJISË PËR TESTIN ERT NË TREGUN ME SHUMICË TË AKSES/ORIGJINIMIT NË RRJETET CELULARE	19
4. RREGULLIMI I TARIFAVE ME SHUMICË TË AKSESIT DHE ORIGJINIMIT NË RRJETIN VODAFONE ALBANIA	20
4.1. BAZA LIGJORE DHE PROBLEMET E IDENTIFIKUARA NGA ANALIZA 2018.....	20
4.2. RREGULLIMI I NIVELIT MAKSIMAL TË TARIFAVE ME SHUMICË TË AKSES/ORIGJINIMIT	21
4.3. TESTI MARGIN SQUEEZE/ERT PËR FNT TË VODAFONE ALBANIA	22
ANEKS 1: TESTI MARGIN SQUEEZE/ERT	26
ANEKS 2-PYETJET E KONSULTIMIT PUBLIK	27

Lista e Tabelave dhe Figurave

<i>Tabela 1. Reduktimi i tarifave te programit me parapagim VODAFONE CARD 2008-2009</i>	5
<i>Tabela 2. Reduktimi i tarifave te programit me parapagim ALBAKARTA te AMC 2008-2009</i>	6
<i>Tabela 3. Rezultatet kryesore të modelit të kostove BULRAIC 2010</i>	7
<i>Tabela 4. Reduktimi i përshkallëzuar i tarifave me shumicë të terminimit të SMS-ve 2012-2014</i>	7
<i>Tabela 5. Reduktimi i përshkallëzuar i tarifave të origjinimit në rrjetet celulare për orientim në kosto BULRAIC</i>	8
<i>Tabela 6. Aplimi i testit ERT/MS për operatorë celulare në vendet evropiane</i>	17
<i>Tabela 7. Aplikimi i testit ERT në nivel me shumicë me korrektim të tarifave me pakicë në vendet evropiane</i>	18
<i>Tabela 8. Niveli maksimal i propozuar për tarifën e origjinimit të thirrjeve në rrjetin Vodafone Albania ...</i>	22

1. Hyrje

Me vendimin nr. Nr.16, datë 22.02.2018 Këshilli Drejtues i AKEP miratoi publikimin e dokumentit “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare - Këshillim publik”. Dokumenti u publikua ne faqen e Internetit te AKEP¹ dhe këshillimi publik u krye për një periudhë 60 ditore më 26.02.2018 – 28.04.2018.

Pas marrjes së komenteve finale të sipërmarrësve si dhe diskutimeve të tjera, AKEP me VKD Nr.____, datë _____.____.2018, miratoi dokumentin “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare” - *Dokumenti Përfundimtar*”. Në bazë të përfundimeve të dokumentit të Anlaizës, Këshilli Drejtues i AKEP ka marrë vendimet përkatëse për sipërmarrësit me FNT dhe masat rregullatore në tregjet përkatëse të analizuara:

- VKD Nr.____, datë _____.____.2018 “Mbi shpalljen e sipërmarrësit Vodafone Albania me Fuqi të Ndjeshme në Tregjet përkatëse: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit, tregu më shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare dhe masat rregullatore”;
- VKD Nr.____, datë _____.____.2018, “Mbi shpalljen e sipërmarrësit Telekom Albania me Fuqi të Ndjeshme në Tregjet përkatëse: tregu më shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe masat rregullatore”;
- VKD Nr.____, datë _____.____.2018, “Mbi shpalljen e sipërmarrësit Altelecom me Fuqi të Ndjeshme në tregun përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe masat rregullatore”

Në lidhje me masën rregullore të rregullimit të tarifave, AKEP ka vendosur që kjo masë të vihet vetëm për statusin me FNT në tregun me shumicë të aksesit/orgjinimit të thirrjeve të sipërmarrsit Vodafone Albania.

Për sa më sipër ky dokument përmban propozimin e AKEP për metodën e rregullimit të tarifave të sipërmarrësve të përcaktuar me FNT në *Tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare*.

Ky dokument nxirret në këshillim publik për një periudhë 1 mujore nga data e publikimit të tij në faqen zyrtare të internetit të AKEP. Pyetjet e këshillimit publik për këtë dokument janë përfshirë në Aneks 2 të këtij dokumenti.

2. Metodatat e rregullimit të tarifave dhe aplikimet e mëparshme në Shqipëri

2.1. Metodatat kryesore të rregullimit të tarifave

Rregullimi i tarifave për operatorët monopol dhe me FNT synon që të adresojë problemet e evidentuara nga analiza e tregut dhe dominanca për konkurrencën në treg, të cilat mund të jenë aplikimi i tarifave shumë të larta ose i tarifave shumë të ulëta në dëm të konkurrencës dhe përdoruesve fundore.

Dy nga metodatat kryesore tradicionale të rregullimit të tarifave në telekomunikacione (përfshirë periudhën e monopoleve në telefoninë fikse) janë:

- Rregullimi i tarifave bazuar në kosto dhe normën e kthimit (fitimit) (Rate Of Return-RoR).

Nëpërmjet kësaj metode përcaktohet norma e rregulluar e fitimit të kompanisë/operatorit monopol në nivelin që një kompani mund të fitojë në një treg konkurrues nga kapitali i investuar. Qëllimi i rregullimit të normës së fitimit (RoR) është të kufizojë fitimin e një firme monopol, deri aty ku një firmë konkurruese të mund të fitojë nga kapitali që ka investuar. Nëse norma reale e fitimit tejkalon normën e lejuar të fitimit, atëherë urdhërohet ulja e tarifave; në të kundërt mund të lejohej rritja e tarifave. Kjo metodë është aplikuar deri në vitet 80 në telekomunikacione, dhe problemi kryesor ishte mungesa e stimuljeve për kompaninë për të reduktuar kostot dhe më pas tarifat. Zakonisht tarifat miratoheshin për secilin shërbim duke mos lejuar fleksibilitet për kompaninë nën-rregullim.

- Rregullimi ecurisë së tarifave të një shporte shërbimesh (*price cap*);

Nëpërmjet kësaj metode tarifat rregullohen duke përcaktuar një shportë apo dhe nënshporta shërbimesh dhe normën e korigjimit të ecurisë së tyre, bazuar në formulën e mëposhtme:

$$\sum_{i=1}^n w_{i,t} \left[\frac{P_{i,t} - P_{i,t-1}}{P_{i,t-1}} \right] \leq I_t - X_t + \alpha$$

Nëpërmjet kësaj metode nuk rregullohet niveli i tarifave për cdo shërbim, por për një grup shërbimesh në bazë të peshave specifike sipas volumit apo të ardhurave, duke i krijuar fleksibilitet operatorit në përcaktimin e cmimeve individuale të shërbimeve si dhe duke i krijuar stimuj për reduktim të kostove/ritje të eficensës.

Rekomandimi i KE 2013/466/EU, ka sugjeruar vendet anëtare të BE për aplikimin e testit të replikueshmërisë ekonomike (ERT) si një instrument rregullator për adresimin e problemit të margin squeeze në tregjet me shumicë të aksesit broadband. Ky instrument ka filluar të përdoret gjerësisht në vendet e BE-së, dhe më shumë detaje për këtë test jepen në kapitullin 3 të këtij dokumenti.

AKEP gjatë rregullimit të tarifave në vite për operatorët me FNT ka zbatuar metoda të ndryshme në varësi të problemeve të evidentuara. Më poshtë është një përshkrim i shkurtër i rregullimit të tarifave me pakicë të Altelecom dhe më pas në seksione të vecanta paraqiten rregullimit e tarifave me shumicë dhe me pakicë të shërbimeve celulare të kryara më parë nga AKEP.

Rregullimi i tarifave me pakicë të operatorit incumbent Albtelecom

Metoda kryesore e aplikuar për rregullimin e tarifave me pakicë të Albtelecom në vitet 2000-2010 ka qenë ‘price cap’ dhe synimi kryesor ka qenë ribalancimi i tarifave të Albtelecom, një proces i ndjekur në shumë vende për ta kaluar nga pajtim mujor shumë i ulët dhe nën-kosto dhe tarifa të larta për thirrje, në rritje të tarifës së pajtimit mujor dhe ulje të tarifave të thirrjeve.

Objektivi kryesor i metodologjise se rregullimit te tarifave te shërbimeve me pakice te Albtelecom në 2008-2010 ishte ribalancimi i tyre, d.m.th orientimi i tarifave drejt kostos se ofrimit te secilit shërbim, si dhe ndryshimi i struktures tarifore, sipas te ciles tarifa e pajtimit mujor dhe tarifa e thirrjeve lokale ishin nen-kosto, dhe te subvencionuara nepermjet te ardhurave nga shërbimet e tjere, si: thirrjet nderkombetare apo shërbimet e interkoneksionit. Ky proces ribalancimit të tarifave të operatorit incumbent të telefonisë fikse është zbatuar në shumë vende sidomos në proceset e liberalizimit të tregut të rrjeteve/telefonisë fikse, pasi si tarifatat shumë të lartë të thirrjeve telefonike dhe tarifatat shumë të ulëta nën-kosto të pajtimit mujor/thirrjeve lokale, si dhe subvencionimi i tërthortë midis shërbimeve me pakicë dhe/ose nga shërbimet me shumicë, përbëjnë problem për konkurrencën në treg dhe përfitimet e përdoruesve fundore nga këto shërbime.

2.2. Rregullimi i tarifave me pakicë të Vodafone Albania dhe AMC në 2008-2010

Metoda e aplikuar për rregullimin e tarifave të këtyre dy operatorëve ishte ‘price cap’ sipas formulës së dhënë më sipër dhe aplikuar për programet kryesore me parapagim (Vodafone Card dhe Albakarta) të dy operatorëve. Objektivi ishte reduktimi i tarifave me pakicë nga nivelet shumë të larta të aplikuara deri në vitin 2008, problem i evidentuar nga analizat e tregut të AKEP. Formula e “price cap”, ku u bazua rregullimi i tarifave celulare ishte:

$$\sum_{i=1}^n w_{i,t} \left[\frac{p_{i,t} - p_{i,t-1}}{p_{i,t-1}} \right] \leq I_t - X_t$$

ku :

- t : periudha kohore për të cilën vendoset tarifa;
- i : indeksi i shërbimit në shportën nën rregullim ($i=1,2,3,\dots,n$);
- n : numri i shërbimeve në shportën nën rregullim;
- $p_{i,t}$: tarifa (çmimi për njësi) i shërbimit i në periudhën t ;
- $p_{i,t-1}$: tarifa (çmimi për njësi) i shërbimit i në fund të periudhës paraardhëse të periudhës t ;
- $\ddot{e}_{i,t}$: pesha e përdorur e shërbimit i në periudhën t ;
- X_t : faktori i produktivitetit i përdorur në periudhën t ;
- I_t : faktori i inflacionit për periudhën $t-1$;

Ky rregullim u aplikua në dy faza Shtator 2008 dhe Shtator 2009, dhe vlera e faktorit X u përcaktuar 23% për shportën e përgjithshme dhe 28% për dy nënshporta, duke rezultuar në reduktim mesatarisht me 40% të tarifave me pakicë me parapagim të këtyre dy operatorëve. Niveli i tarifave, për dy programet me parapagim të perzgjedhur, para aplikimit të metodologjise, në secilen prej fazave të metodologjise dhe reduktimet në përqindje si efekt i zbatimit të metodologjise, paraqiten në dy tabelat e mëposhteme.

Tabela 1. Reduktimi i tarifave të programit me parapagim VODAFONE CARD 2008-2009

	Shtator 2008	Metodologjia: Shtator 2008-	Metodologjia: Shtator 2009	Ndryshimi Metodologjia
Brenda rrjetit (on-net) peak	45,60	34,80	30,00	-34%
Brenda Rrjetit (on-net) Off-peak	36,00	34,80	30,00	-17%
Drejt operatorëve të tjerë celularë (off-net)	60,00	45,60	35,88	-40%
Drejt rrjeteve fiks	45,60	33,60	25,20	-45%

Shënim: Tarifat në Lek/ minutë me TVSH

Burimi: Analiza e tregut celular 2010

Tabela 2. Reduktimi i tarifave të programit me parapagim ALBAKARTA të AMC 2008-2009

		Shtator 2008	Metodologjia Shtator 2008-	Metodologjia: Shtator 2009	Ndryshimi Metodologjia
Brenda rrjetit (on-net)	<i>minuta e parë</i>	45,00	43,08	29,40	-35%
	<i>minuta e dyte</i>	45,00	19,20	14,40	-68%
	<i>mbi dy minuta</i>	45,00	14,40	7,08	-84%
Drejt operatorëve të tjerë celularë (off-net)	<i>minuta e parë</i>	62,40	50,02	35,88	-43%
	<i>minuta e dyte</i>	52,80	24,61	19,44	-63%
	<i>mbi dy minuta</i>	52,80	19,45	16,80	-68%
Drejt rrjeteve fiks:	<i>minuta e parë</i>	48,00	37,40	25,20	-48%
	<i>minuta e dyte</i>	36,00	18,88	11,64	-68%
	<i>mbi dy minuta</i>	36,00	14,64	8,40	-77%

Shënim: Tarifat në Lek/ minutë me TVSH

Burimi: Analiza e tregut celular 2010

Nje ndër problemet e evidentuara në analize 2007 ishte aplikimi i kohës minimale prej 30 sekondash (që pati rritje nga 20 sekonda që ishte më parë për disa lloj thirrjesh), e cila çonte në mënyrë të rëndësishme të tarifave të shërbimit të komunikimit për përdoruesit me parapagim. Për të dy operatorët celularë nëpërmjet implementimit të metodologjisë u aplikua reduktimi i kohës minimale të tarifueshme nga 30 sekonda në 15 sekonda, një ndryshim i rëndësishëm për konsumatorët i cila së bashku me reduktimin e tarifave për minute çon në zvogëlim të ndjeshëm të shpenzimeve për thirrjet me kohezgjatje të vogël.

Më hyrjen në treg të dy operatorëve të rinj, Eagle Mobile (Albtelecom) dhe Plus Communication, AKEP në përfundim të analizës së tregut në vitin 2010 vendosi që të nxirrte nga rregullimi tarifave me pakicë të Vodafone dhe AMC (sot Telekom Albania).

2.3. Rregullimi i tarifave të terminimit në rrjetet celularë

Niveli i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celularë ka qenë objekt i rregullimit ex-ante nga AKEP (më parë ERT) që nga viti 2006. Rregullimi i këtyre tarifave nga AKEP deri në vitin 2010 është kryer duke përdorur nivelin mesatar të tarifave të terminimit në vendet e BE, dhe duke filluar nga viti 2010 deri në Mars 2014, ky rregullim është kryer bazuar në reduktimin e përshkallëzuar për orientimin në kosto drejt vlerës së nxjerrë nga modeli BU-LRAIC² i ndërtuar në vitin 2010 nga

² Bottom-Up Long Run Average Incremental Cost (Modeli Poshtë-Lart i Kostos Mesatare Inkrementale Afatgjatë)

AKEP me konsulencë ndërkombëtare. Rezultatet kryesore të këtij modeli BULRAIC³ për rrjetet celulare janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Tabela 3. Rezultatet kryesore të modelit të kostove BULRAIC 2010

Shërbimi	Njësia	Kosto
Terminimi i Thirrjeve	minutë	4.57
Origjinimi i Thirrjeve	minutë	4.51
Thirrjet on-net	minutë	7.17
SMS on net	mesazh	0.60
SMS dalëse	mesazh	0.58
SMS hyrëse	mesazh	0.58
GPRS doënloads	megabit	5.14

Shënim: Kostot në Lek, pa TVSH

Duke filluar nga Prill 2014 AKEP ka përdorur sërish metodën benchmark për rregullimin e tarifave MTR, si benchmark është përdorur vlera mesatare e tarifave të terminimit në vendet Evropiane që kanë aplikuar modelin e kostove LRIC të paster, sipas rekomandimit të vitit 2009 të KE. Edhe në procesin e këshillimit publik në Dhjetor 2016 dhe Shkurt 2018, AKEP ka propozuar që MTR të rregullohen sipas kësaj metode duke propozuar glide path përkatëse. Modeli BULRAIC në vitin 2010 tashmë referohet si LRIC+ ndërsa metoda e rekomanduar nga KE dhe e përdorur në shumicën e vendeve evropiane tashmë është Pure LRIC. Dokumentat e këshillimit publik për MTR në [Dhjetor 2016](#) dhe [Shkurt 2018](#) përmbajnë më shumë detaje rreth metodës Pure LRIC dhe benchmarkut të propozuar nga AKEP për MTR në Shqipëri si dhe rregullimet e mëprshme të AKEP për MTR.

AKEP ka vendosur nën rregullim dhe tarifën me shumicë të terminimit të SMS-ve kombëtare duke aplikuar një glide path në periudhën 2012-2014, sipas vlerave në tabelën e mëposhtme.

Tabela 4. Reduktimi i përshkallëzuar i tarifave me shumicë të terminimit të SMS-ve 2012-2014

	Deri më 31.12.2011	1.01.2012	1.09.2012	1.09.2013	1.04.2014-në një vendim tjetër të AKEP
Katër operatorët Celularë	3.00	2.40	2.00	1.44	1.00

Shënim: Tarifën në Lek/SMS, pa TVSH.

2.4. Rregullimi i tarifave të aksesit origjinimit në rrjetet celulare 2010-2012

AKEP bazuar në analizën e tregut celular në vitin 2010, me vendimet Nr. 1210-1211, datë 31.03.2010, përcaktoi AMC (tani TELEKOM ALBANIA) dhe Vodafone Albania si sipërmarrës me FNT për shërbimet e aksesit/origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare, duke përcaktuar ndër të tjera që *tarifa e aksesit dhe origjinimit të thirrjeve dhe shërbimeve të interkoneksionit të lidhura me aksesin dhe origjinimin e thirrjeve në rrjetet AMC (tani TELEKOM ALBANIA)/Vodafone Albania janë:*

³ Dokumentacioni i plotw pwr orientimin e tarifave celulare nw kostot BULRAIC mund tw gjendet nw kwtw link: <https://www.akep.al/images/stories/AKEP/publikime/Vendim-nr-1505-date-10-02-2011.pdf>

- i. Objekt kontrolli nga AKEP për shërbime të origjinimit të thirrjeve drejt numrave të ofruesve të thirrjeve me karta të parapaguara (OSHKP) dhe numrave pa pagesë 0800xxx:
 - a. Tarifa maksimale e origjinimit të thirrjeve të jetë 10.50 lekë/minutë dhe tarifë 0.31 lekë/për thirrje;
 - b. Tarifa aplikohet për kohëzgjatjen e thirrjes (dhe numrin e thirrjeve) së suksesshme drejt platformës së OSHKP apo call center;
 - c. Zbatimi i detyrimit të ndarjes së llogarive dhe mbajtjes së llogarive (nenet 42 dhe 45) dhe zbatimi i detyrimit të orientimit në kosto të tarifave të interkoneksionit (neni 59), do të kryhet në bazë të përcaktimeve të mëvonshme të AKEP.
- ii. Objekt negociatash komerciale për shërbimet e tjera të akses dhe origjinimit të thirrjeve përfshirë MVNO, rishitës të shërbimeve celulare të sipërmarrësve AMC (sot Telekom Albania) dhe Vodafone Albania..

Pas përfundimit të modelit të kostove BULRAIC në vitin 2010 (Tabela 3 më sipër) dhe këshillimit publik në vitin 2011, AKEP në Shkurt 2011 përcaktoi një glide path për reduktimin e tarifave të akses/origjinimit në rrjetet AMC (sot Telekom Albania) dhe Vodafone Albania për të arritur në nivelet e kostove të modelit BULRAIC sipas tabelës së mëposhtëme.

Tabela 5. Reduktimi i përshkallëzuar i tarifave të origjinimit në rrjetet celulare për orientim në kosto BULRAIC

	2010	1 Mars 2011	1 Shtator 2011	1 Shtator 2012	1 Shtator 2013	1 Shtator 2014
AMC (Telekom Albania)/ Vodafone Albania	10.50	8.85	7.57	6.10	4.51	4.51

Shënim: Tarifat në Lek/minutë, pa TVSH

3. Aplikimi i testit Margin Squeeze në vendet e BE/BEREC


3.1. Testi Margin Squeeze/ERT dhe rekomandimi i KE

Një operator me FNT apo dominant konsiderohet se abuzon me fuqinë e tregut nëse shet produkte/shërbimet në pjesë të ndryshme të zinxhirit të vlerës mes tregjeve të rrjedhjes së sipërme(shumicës) dhe të rrjedhjes së poshtme(pakicës) me një marzh shumë të ulët që vështirëson konkurrencën e në treg nga operatorët e tjerë si dhe mbijetesën financiare të tyre. Pra këta operatorë nuk kanë mundësi të replikojnë produktet/tarifat me pakicë të operatorit me FNT, duke nxjerrë një normë të arsyeshme fitimi, ose mund të përshtasin tarifat me pakicë duke rezultuar në humbje financiare dhe në periudha afatgjata kjo sjellje (margin squeeze) e operatorit me FNT çon në nxjerrjen e konkurrentëve nga tregu.

Testet alternative në rastet e rregullimit të marzhit apo diferencës midis tarifave mes shumicës dhe pakicës përfshijnë testin e margin squeeze dhe testin e replikueshmërisë ekonomike, të sugjeruar nga KE në rekomandimin 2013/466/EU. Autoritetet rregullatore ndeshen me dy objektiva të kundërt në rregullimin e diferencës apo marzhit të tarifave me shumicë dhe me pakicë të operatorit me FNT:

- Rregullatori duhet të garantojë që marzhi midis tarifave me shumicë dhe me pakicë është i mjaftueshëm që të krijojë hapësirë për operatorët e tjerë të konkurrojnë, dhe me një fitim të arsyeshëm, pra që do thotë që operatori me FNT nuk duhet të kufizojë konkurrencën, nëpërmjet zbatimit të tarifave të larta të paarsyeshme (në nivel me shumicë) ose tarifave të ulëta të paarsyeshme (në nivel me pakicë);
- operatori me FNT kërkon që të ketë mundësi të konkurrojë në tregun me pakicë me tarifa të ulëta, në përfitim të përdoruesve fundorë.

Në mënyrë skematike, këto objektiva të kundërt paraqiten në skemën e mëposhtme.



Dy objektivat e mësipërm janë të kundërt me njëri tjetrin dhe rregullatori duhet të vendosë një balancë midis tyre në dizenjimin e testit MS/ERT, në mënyrë që implemtimi i tij të rezultojë në promovim të konkurrencës së qëndrueshme dhe efektive dhe përfitimeve të konsumatrëve në periudhë afat-mesme/afat-gjatë.

Ky kapitull vijon me informacion mbi dokumentat e KE dhe BEREC që kanë lidhje me aplikimin e testit Margin Squeeze/ERT në vendet e BE/BEREC. Për këtë është përdorur informacion kryesisht nga dokumentat/burimet e mëposhtëme:

- **Rekomandimi i KE 11 Shtator 2013**

COMMISSION RECOMMENDATION of 11 September 2013 on consistent non-discrimination obligations and costing methodologies to promote competition and enhance the broadband investment environment (2013/466/EU)

- **Udhëzimi i BEREC BoR (14) 190**

BEREC Guidance on the regulatory accounting approach to the economic replicability test (i.e. ex-ante/sector specific margin squeeze tests)

- **Informacion nga Cullen International**

Price squeeze and economic replicability tests CTTEEU20170203 - 20 Dec. 2017

Rekomandimi 2013/466/EU rekomandon që për tregjet me shumicë të aksesit broadband në rrjetet fikse mund të hiqet detyrimi i kontrollit të tarifës dhe orientimit në kosto, por duke shtuar detyrimet e mos-diskriminimit, (EoI-Equivalence of Inputs, Replikueshmeri teknike dhe Replikueshmeri Ekonomike). Heqja e detyrimit të kontrollit të tarifës rekomandohet të jete e kushtezuar me zbatimin ketyre tre detyrimeve shtese për mos-diskriminim nga operatori me FNT i cili duhet të ketë barren e vertetimit të zbatimit të tyre.

Rekomandimi mundëson fleksibilitet në tarifimin e produkteve me shumicë të NGA (pra jo orientim në kosto) nëse aplikohen disa masa parandaluese/mbrojtëse të konkurrencës, përfshirë testin ex-ante të replikueshmërisë ekonomike (*Economic Replicability Test-ERT*)

Rekomandimi përcakton testin ex-ante të replikueshmërisë ekonomike si testi i cili vlerëson nëse marzhi (apo diferenca) midis çmimit të shitjes me pakicë të produkteve përkatëse dhe çmimeve të inpueteve përkatëse të rregulluara me shumicë në NGA mbulon kostot shtesë të rrjedhës së poshtme dhe një përqindje të arsyeshme të kostove të përbashkëta. Testi i Replikueshmërisë Ekonomike dështon nëse divizioni me pakicë i operatorit me FNT nuk do të mund të tregtonte me fitim sipas çmimve të aplikuara me shumicë për konkurrentët e tij, pra konkurrentët e operatorit me FNT në tregun me shumicë nuk kanë mundësi të replikojnë produktet në tregun me pakicë të operatorit me FNT, dhe për rrjedhojë nuk kanë mundësi të konkurrojnë në tregun me pakicë.

Testi ERT konsiderohet si një rast specifik i testit margin squeeze, ku ky i fundit është një test që aplikohet dhe nga rregullatorët por edhe ex-post nga autoritetet e konkurrencës në zbatim të ligjit të konkurrencës.

BEREC në dokumentin BoR (14) 190 sqaron se testi margin-squeeze është një mënyrë për të identifikuar rastet kur operatori me FNT (vertikalisht i integruar pra prezent në nivelin me shumicë

dhe me pakicë) mund të përcaktojë një marzh shumë të vogël midis cmimeve të produkteve me pakicë dhe inputeve përkatëse me shumicë, dhe në këtë mënyrë potencialisht mund të nxjerrë operatorët e tjerë nga tregu. Pra testi margin-squeeze përcakton një diferencë minimale midis cmimit me pakicë dhe cmimit me shumicë dhe në këtë rasts mund të identifikohen dy situata:

- Cmimi me pakicë lidhet me një nivel të dhënë (d.m.th të orientuar në kosto) të cmimit me shumicë: në këtë rasts testi MS garanton që cmimi me pakicë nuk është më i ulët se një nivel i caktuar (antikurrues).
- Cmimi me shumicë lidhet me një nivel të dhënë (d.m.th konkurrues) të cmimit me pakicë: Në këtë rast testi MS garanton që cmimi me shumicë nuk është më i lartë se një nivel i caktuar që nuk lejon replikueshmëri për operatorët e tjerë ose që diskriminon ata nëpërmjet cmimeve me shumicë që janë më të lëta se ato të aplikuar në mënyrë të brendshme (internal pricing) nga operatori me FNT për divizionin e vet me pakicë.

Testi MS lejon më shumë fleksibilitet për operatorin me FNT të përcaktojë cmimet se sa rregullimi i cmimeve nëpërmjet orientimit në kosto të tyre. Qëllimi i testit ERT është që, në kombinim dhe me masa të tjera mbrojtëse të konkurrencës, të garantojë që operatorët me FNT të mos abuzojnë me fleksibilitetin e tarifimit për të përjashtuar konkurrentët (potencialë) nga tregu.

Sipas BEREC dhe Rekomandimit të BE, testi ERT duhet të specifikojë të paktën parametrat e mëposhtëm:

- i. Kosto të nivelit të poshtëm përkatës (doëstream cost);

Këto kosto duhet të vlerësohen në bazë të kostove të operatorit me FNT (testi EEO) duke përdorur kostot e audituara të këtij operatori, me kushtin që ato të jenë mjaftueshmërisht të ndara(diz-agreguara). Rregullatorët mund të kryejnë axhustime të këtyre kostove për ta përshtatur me madhësinë e operatorëve të tjerë, pra një nivel të arsyeshëm efience.

- ii. Standardin ekostove përkatës;

Për koston e ofrimit të shërbimeve në nivelin e poshtëm, rregullatorët duhet të përdorin modelin LRIC+, që përfshin dhe kostot e humbura dhe të shtojnë një marzh për kostot e përbashkëta për ofrimin e aktiviteteve të rrjedhës së poshtme.

- iii. Inputet përkatëse me shumicë të rregulluara dhe cmimet referencë përkatëse;

Rregullatorët duhet të identifikojnë inputet më kryesorë (relevantë) të nevojshëm për ofrimin e produkteve me pakicë. Në identifikimin e cmimeve referencë me shumicë, rregullatori duhet të marrë në konsideratë cmimet e akseist që operatori me FNT tarifin për operatorët e tjerë për inputin përkatës me shumicë që duhet të jetë i njëjtë me atë që i tarfin së brendshme. Rregullatorët duhet t'i japin rëndësinë e duhur prezencë së skontove për volumin dhe/ose marrveshjeve afatgjata të operatorit me FNT me përfitues të aksesit.

- iv. Produktet përkatëse me pakicë;

Rregullatorët duhet të vlerësojnë produktet përkatës me pakicë që janë më të rëndësishme apo kryesore për operatorin me FNT (flagship products), duke marrë në konsideratë rëndësinë e tyre në konkurrencën aktuale dhe në të ardhmen në tregun me pakicë. Pra testi për 'Flagship

products' nënkupton që testi nuk aplikohet për të gjitha produktet apo oferta e reja me pakicë por vetëm në lidhje me produktet flagship, të cilat identifikohen nga rregullatori në bazë të rëndësisë së tyre sipas volumit/vlerës etj.

- v. Periudhën përkatëse kohore për të aplikuar testin.

Rregullatorët duhet të vlerësojnë profitabilitetin e produkteve kryesore me pakicë në bazë të një analize dinamike për shumë periudha, si Discounted Cash Floë (DCF). Periudha përkatëse për këtë test ex-ante duhet të jetë në përputhje me kohëzgjatjen mesatare të klientit.

Në lidhje me nivelin e eficensës së zgjedhur, në test duhet të përcaktohet nëse do të përdoret ai i operatorit me FNT apo niveli i eficensës së një operatori gjenerik alternativ. Për këtë ekzistojnë 3 zgjedhje:

- Equally efficient operator (EEO): niveli i eficensës së një operatori me madhësinë e operatorit me FNT (burimi: kontabilitetit rregullator).
- Reasonably efficient operator (REO): niveli i eficensës së një operatori gjenerik (alternativ) që nuk ka ende madhësinë e operatorit me FNT
- Adjusted equally efficient operator (adjusted EEO): testi fillon me kostot e operatorit me FNT dhe më pas korrektohet për madhësinë e një operatori gjenerik (alternativ).

3.2. Zbatimi i MS/ERT në vendet e BE/BEREC

Formula

Sipas informacionit të marrë nga vendet anëtare, BEREC shpjegon se për testin MS nuk ka një përkufizim standard të përdorur, por qëllimi i tij është që të vlerësojë nëse cmimi me pakicë i operatorit me FNT mbulon shpenzimet (kostot) e shërbimeve me shumicë nën-rregullim që janë të nevojshme për ofrimin e produktit me pakicë, kostot e inputeve që nuk janë nën-rregullim (përfshirë kostot e rrejtit të vet) dhe kostot retail:

Testi ERT vlerëson nëse cmimi me pakicë i operatorit me FNT për produktin/produktet kryesore (flagship) ose produktet që vlerësohen të rëndësishme nga rregullatori mbulon kostot e shërbimeve nën-rregullim, kostot e inputeve që nuk janë nën-rregullim (përfshirë kostot e rrejtit të vet) dhe kostot me pakicë.

Formula e përgjithsme për testin ex-ante të ERT:

$$RP_{\text{smp}} \geq WC_{\text{reg}} + WC_{\text{non-reg}} + RC.$$

Ku:

- RP_{smp} = Çmimi me pakicë i produktit të operatorit me FNT;
- WC_{reg} = Kostot e inputeve me shumicë nën-rregullim të nevojshme për ofrimin e produktit me pakicë të operatorit me FNT;

- WCnon-reg = Kostot e inuteve me shumicë që nuk janë nën-rregullim të nevojshme për ofrimin e produktit me pakicë (përfshirë kostot e rrjetit të vet);
- RC = Kostot Retail.

Kostot

Në lidhje me kostot BEREC citon se vendet e BE zbatojnë kombinime të ndryshme të standardeve të kostove si LRIC+ dhe FAC, ku kjo e fundit përdoret kryesisht për kostot retail. Për kostot me shumicë të inuteve që janë nën-rregullim zakonisht përdoren tarifatat me shumicë të operatorit me FNT nga ofertat referencë të tij. Në lidhje me kostot retail rekomandimi i BE përfshin si kategori kryesore marketingun, kostot e përfitimit të klientit dhe faturimin dhe rregullatorët përfshijnë gjithashtu kostot e kujdesit ndaj klientit, borxhi i keq, menxhim/zhvillimi i produkteve dhe operacione të tjera retail. Kategoritë e kostove varen dhe specifikat e produktit retail që testohet për MS.

Në lidhje me kostot me shumicë të inuteve që nuk janë nën-rregullim disa rregullatorë përdorin kostot e operatorit me FNT për këto inute (kryesisht LRIC+), ose në rastet e përdorimit të metodës së efikasë REO/REO e korriguar merren në konsideratë kostot e operatorit alternative. Ndërkohë si alternative në rastet kur nuk ka të dhëna për këto kosto me shumicë, si proxy për kostot mund të përdoren tarifatat komerciale të rena dakort në tregun me shumicë të bartësve.

Në lidhje me sasinë e trafikut të përdorur për test dhe kostot përkatëse, mund të përdoren minutat/të dhënat të përfshira në produktin me pakicë ose një profil i përdoruesit apo përdorimit mesatar.

Produktet përkatëse me pakicë objekt i testit

Shumica e rregullatorëve përfshijnë një game të gjerë të produkteve retail që janë objekt i testit MS/ERT, ndërsa si kriter për të përcaktuar produktet kryesore (flagship) përdoret pesha e të ardhurave që gjenerojnë produktet d.m.th zgjidhen ato produkte që kanë peshë më të madhe në të ardhurat e operatorit me FNT. Kriteret e tjera të mundshme janë shpenzimet e publicitetit apo numri i pajtimtarëve/klientëve të produkteve.

Rekomandimi i BE nuk përmban detaje në lidhje me nivelin e agregimit të produkteve që i nënshtrohen testit (p.sh. cdo produkt retail individualisht ose një protokoll i produkteve kryesore të identifikuar). BEREC për këtë çështje shprehet se cdo rregullator duhet të përcaktojë vet nivelin duhur të agregimit të produkteve që do jenë objekt i testit në varësi të problemeve të konkurrencës së identifikuar në analizën e tregut.

Në lidhje me paketat e integruara rekomandimi shprehet se ato duhet të merren në konsideratë dhe objekt i testit nuk janë vetëm paketat që përmbajnë inute me shumicë nën-rregullim. Sipas BEREC paketat e shërbimeve duhet të jenë objekt i testit nëse ato janë të rëndësishme në tregun me pakicë dhe të gjitha paketat që përmbajnë shërbime me shumicë nën-rregullim duhet t'i nënshtrohen testit MS/ERT. Për shkak se rekomandimi nuk shprehet se si duhet të vlerësohen elementët jashtë rregullimit të paketave, BEREC rekomandon që rregullatorët duhet t'i vlerësojnë këto komponentë në varësi të kushteve lokale.

Në lidhje me promocionet dhe skontot e përkohëshme, BEREC shprehet se ato duhet të merren në konsideratë për testin MS, por rregullatorët duhet të kenë fleksibilitet se si të përfshijnë këto promocione në test. BEREC sugjeron se ato duhet të njoftohen paraprakisht nga operatori me FNT

në mënyrë që rregulatori të ketë kohën e nevojshme për të zbuluar praktikatat që mund të dëmtojnë konkurrencën dhe ti evitojë në kohën e duhur ato.

Procedura dhe transparenca e aplikimit të testit

Në lidhje me procedurën e aplikimit të testit dhe transparencën e tij Rekomandimi në paragraf 66 citon se autoritetet rregullatorë në vijim të analizave të tregut e publikojnë në avancë procedurën e zbatimit të testit të replikueshmërisë ekonomike⁴.

Një nga çështjet më të rëndësishme në dizenjimin e testit MS është përcaktimi i rasteve për fillimin apo kryerjen e testit MS. BEREC sugjeron një listë me këto raste (trigger event):

- Hedhja në treg e një produkti të ri retail;
- Korrektimi i i cmimit me pakicë ose cmimit korrespondues me shumicë;
- Promocion;
- Ndryshimi i ndonjë komponenti të përfshirë në një produkt retail ekzistues në treg
- Ndryshim i cilësisë së produktit/shërbimi me pakicë;
- Analizë tregu.

Megjithatë, BEREC shprehet se është e mundur që testi të aplikohet në mënyrë periodike (p.sh një herë ose dy herë në vit), pavarësisht hedhjes ose jo në treg të produkteve të reja me shumicë ose me pakicë.

Në shumicën e vendeve të BEREC, rregullatorët e aplikojnë testin **ex-ante** për të garantuar që tarifimi i inputit me shumicë lejon një marzh midis cmimit me shumicë dhe me pakicë. Në shumicën e vendeve, testit MS aplikohet si pjesë apo me referencë detyrimin e mos-diskriminimit ose detyrimin e kontrollit të tarifës të vendosur në tregjet me shumicë (kryesht tregu nr.4 dhe 5 i rekomandimit 2014 të KE). Një numër më i vogël i rregullatorëve e aplikojnë testin ex-ante të MS duke i'u referuar detyrimin të kontrollit të tarifave të vendosur në tregun me pakicë, si një instrument për të verifikuar që tarifa me pakicë lejon një marzh për operatorët alternativë për të konkurruar në tregun me pakicë pa pësuar humbje.

Shumica e rregullatorëve kanë diskrecion të konsiderueshëm se kur mund të kryejnë testin ex-ante të MS, i cili mund të kryhet me iniciativë të rregullatorit apo me kërkesë të palëve të treta (ankesa). Shumica e rregullatorëve të BEREC e konsiderojnë hedhjen në treg të një produkti të ri si një ngjarje

⁴ “The NRA should set out and **make public in advance in its adopted measure following a market analysis the procedure and parameters it will apply when running the ex ante economic replicability test.** The NRA **may run the test before the launch** of a new retail offer by the SMP operator, e.g. if the NRA considers it appropriate to align the timing of the economic replicability test with the technical replicability test if also undertaken before launch. **The NRA need not to run the test for each and every new retail offer but only in relation to flagship products** to be identified by the NRA. An NRA **may run the test at its own initiative**, for example in the initial stages of the implementation of a measure that allows pricing flexibility on NGA networks, particularly where regulated wholesale access prices were imposed in the past, **or to respond to changes in the structure of the market**, for example as a result of technological developments”

që inicion testin MS, por ato nuk kanë limite të paracaktuara se kur mund të fillojnë apo përfundojnë një procedure testi MS. BEREC shprehet se në përgjithësi, për dizejimin e një testi MS, nuk ka shumë rëndësi nëse testi MS është vendosur si një detyrim (masë rregullatore) në tregun me shumicë apo me pakicë.⁵

Detyrimi për operatorin me FNT për njoftimin e produkteve/promocioneve të reja

Në mënyrë që rregulltari të verifikojë nëse tarifat me pakicë të paketave të reja ose ndryshimet e tyre janë në përputhje me testin MS, operatorit me FNT i vendoset detyrimi që të njoftojë ato para hyrjes në fuqi të tyre. Në lidhje me afatin kohor të njoftimit paraprak, ai varion nga 6 muaj deri në 5 dite pune para hedhjes në treg të paketave të reja me pakicë apo ndryshimeve të tyre, ndërsa afati mesatar është 30 ditë para hedhjes në treg. Disa rregullatorë vendosin afate të ndryshme njoftimi për produkte/paketa të reja, ndryshim në paketat ekzsituase apo promocione.

Procedura e autorizimit/miratimit

Në rastet kur hedhja në treg e një produkti të ri me pakicë përbën shkak (trigger event) për aplikim të testit MS, rregullatori mund të përcaktojë një procedurë që ndalon operatorin me FNT të hedhë produktin në treg derisa rregullatori të ketë përcaktuar që produkti i ri me pakicë është në përputhje (kalon) testin MS. Sipas BEREC shumica e vendeve që aplikojnë testin ex-nate të MS nuk i kërkojnë operatorit me FNT të marrë miratimin paraprak nga rregullatori para hedhjes në treg të një produkti të ri apo të modifikuar me pakicë. Ndërsa për autoritetet rregullatore që kanë vendosur si detyrim për operatorin me FNT miratimin paraprak të paketave të reja apo të modifikuar me pakicë para hedhjes në treg të tyre, ekzistojnë dy situata:

- Testi MS është vendosur si masë rregullatore në tregun me shumicë dhe rregullatori e përdor testin për të vendosur tarifat me shumicë;
- Testi MS është një instrument që përdoret nga rregullatori për vlerësuar replikueshmërinë e paketës me pakicë nga operatorët e tjerë.

Megjithatë në disa vende operatori me FNT kërkon vullnetarisht miratimin paraprak nga rregullatori për të shmangur hetimin nga rregullatori dhe më pas terheqjen e mundshme të paketës retail nga tregu.

Kërkesa për informacion shtesë

Me qëllim që të kryejnë testin MS, rregullatorët mund dhe kanë të drejtë të kërkojnë informacion shtesë nga operatori me FNT. Zakonisht kontabiliteti rregullator nuk ofron të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me kostot dhe volumin e shërbimeve për të kryer testin MS.

Në këto raste rregullatorët kërkojnë informacion shtesë ad-hoc dhe disa rregullatorë të vendeve të BEREC kanë përcaktuar afate kohore për informacionin shtesë dhe pezullimin e aplikimit të testit deri në marrjen e informacionit shtesë. Si një burim shtesë informacioni rregullatorët mund të përdorin edhe benchmark për tarifat me pakicë.

⁵ BoR (14) 190, page 42: *In general, for the design of the margin squeeze test, it does not matter much if the margin squeeze test has been imposed as a wholesale or a retail obligation.*

Pasoja e mos-kalimit të testit

Në rast se një paketë produkti me pakicë e operatorit me FNT rezulton jo e replikueshme sipas testit ex-ante të MS, vendet e BEREC aplikojnë metoda të ndryshme korrektimi për të ri-vendosur kushtet e konkurrencës në treg. Rregullatori në këto raste ka të drejtë t'i kërkojë operatorit me FNT të ndryshojë ose tërheqë produktin që nuk kalon testin MS. Metoda më e përdorur nga rregullatorët e vendeve të BEREC është korrektimi i cmimit me kërkesë të rregullatorit ose me inisiativë të operatorit me FNT, sipas tre alternativave të mëposhtme:

1. Rritje e tarifës së paketës në nivel me pakicë;
2. Ulje e tarifave me shumicë të inuteve që janë nën-rregullim;
3. Korrektim i tarifave në nivel me shumicë dhe me pakicë.

Nje pjesë e vogël e rregullatorëve aplikojnë sanksione me gjopa nëse operatori me FNT dështon të kalojë testin MS dhe detyrimeve të FNT.

Procedura në rast ankimi nga palë të treta

Rekomandimi i BE parashikon që rregullatori mund të kryejë testin e replikueshmërisë me kërkesë të palëve të treta, dhe pothuajse të gjitha vendet e BEREC i japin mundësinë operatorëve alternativë të paraqesin ankesë në lidhje me komercializimin e një produkti (i vlerësuar/testuar ose jo më parë nga rregullatori).

Cështje të transparencës dhe konfidencialitetit

Aplikimi i testit MS kryhet për të mbrojtur konkurrentët e operatorit me FNT nga sjelljet diskriminuese dhe antikonkurruese të këtij të fundit dhe transparenca e procesit është e rëndësishme. Megjithatë aplikimi i testit në shumë raste kërkon përdorimin e të dhënave konfidenciali të operatorit me FNT dhe publikimi i këtyre të dhënave dhe disa parametra specifike të testit apo rasteve specifike të aplikimit të testit mund të krijojnë probleme me konfidencialitetin e të dhënave.

Sipas BEREC rregullatorët në shumicën e vendeve publikojnë metodologjinë e përgjithshme dhe parametrat kryesorë të testit MS në proces konsultimi publik, ndërkohë rregullatori zakonisht nuk përfshin operatorët alternativë në aplikimin e testit MS në rastet konkrete për shkak të konfidencialitetit të të dhënave.

Përfundim

Tabelat e mëposhtme japin informacion mbi aplikimin e testit ex-ante MS/ERT në vendet e BE/BEREC. Sic është cituar në fillim të këtij kapitulli dhe nga rekomandimi KE, testi ERT aplikohet kryesisht si detyrim apo pjesë e masave rregullatore në tregjet me shumicë të aksesit broadband nga rrjete fikse. Megjithatë parimet e aplikimit të tij zbatohen nga disa vende edhe në tregje të tjera, përfshirë rrjetet celulare si Norvegjia (tregu me shumicë i akses/organizimit në rrjetet celulare), Çekia

(ëholesale mobile BB në rrjet LTE) dhe Turqia (tregu me pakice celulare dhe inputet perkatese me shumice).

Tabela 6. Aplimi i testit ERT/MS për operatorë celulare në vendet evropiane

Ne tregun e telefonise mobile	Ne tregun e sherbimeve me pakice	Niveli i te dhenave per testin	Relevant wholesale products?	Loji I testit? (efficiency level)	Kostot e rrjedhes se poshtme (retail, marketing, billing...)?	Vlerësimi i komponentëve të parregulluar të paketave bundle	Koha dhe metodologjia e pershtatshme per aderhyrje rregulluese	Periodiciteti	Afati per vendimarrjen e NRA?	Cfare ndodh nese testi deshton?
3 vende										
Republika ceke	Mobile broadband	Test te gjithe portofolit	Tjeter	EEO The basic principle is EEO but adjusted EEO might apply.	LRAIC+	Not applicable	Period by period assessment Over customer lifetime, based on the churn rate	Paspecifikuar	No deadline, operator not required to wait for NRA decision	Adjustment of wholesale prices Adjustment of wholesale prices by operators following the NRA check of compliance.
Norvegjia	Fixed broadband access Mobile broadband Mobile calls	Test te gjithe portofolit	Per odo input te shitjes me shumice ne menyre te ndare	Adjusted EEO	MS/2007 LRAIC+ Where LRAIC data is not available, FDC will be used M15/2003 Other (total costs)	MS/2007 Included in the test M15/2003 Unspecified	MS/2007 Other Steady state analysis over customer lifetime for fibre-based retail services. M15/2003 Period by period approach Over 12 months	Other An ex ante PST each time a new wholesale price in 5/2007 is determined and/or a new wholesale product is introduced. Periodic PST for individual wholesale products every 6 months, in line with the existing 6-month collection of subscriber data for Nkom's statistics. Additional PSTs may also be conducted under reasonable and proportionate circumstances, in particular if competitors make justified reasoning of major market changes related to costs, prices, and customer distribution which would lead to different results compared to the original ex ante PST.	Explicit NRA decision Within 30 days (normally) max. legal deadline is 4 months, para 11-2 of the Ecom Act	Adjustment of wholesale prices Nkom may order Telenor to change the wholesale prices (para 10-6 of the Ecom Act) Nkom may also impose infringement fines, reimbursement or coercive fines (para 10-3, 10-12 and 10-7 of the Ecom Act)
Turqia	Mobile voice Mobile broadband Fixed voice Fixed access Fixed broadband	Per odo produkt per 10 tarifet me te shitura te operatorit SMP (ne terma perdonuesish dhe te ardhurash)	Per odo input te shitjes me shumice ne menyre te ndare	REO	LRAIC	Included in the test	Unspecified	Before launch of retail offer Price squeeze test has to be applied 1 month prior to the launch of all new tariffs. ICTA can apply an ex post test once per year for all current tariffs or	Explicit NRA decision ICTA must complete the test within 14 days after all necessary	Adjustment of retail prices Operators cannot launch their tariffs before passing the price squeeze tests of ICTA.

Burimi: Cullen International

Tabela 7. Aplikimi i testit ERT në nivel me shumicë me korrektim të tarifave me pakicë në vendet evropiane

	Periodicity?	Deadline for NRA decision?	What happens if the test fails?
Austria	Other TKK examines compliance once per year. The decisions on M3a+3b/2014 specify minimum margins between retail and wholesale prices and between monthly ARPU and wholesale prices (Flash). If AITA introduced a too low retail price (in particular during promotion periods) it would have to offer a correspondingly lower wholesale price. AITA must inform ANOs in advance to allow them to replicate AITA retail offers: four weeks before introducing new prices (including promotion discounts), in other cases 8, 12 or 16 weeks.	Not applicable	Adjustment of retail and/or wholesale prices NRA may set wholesale prices and/or order operator to stop charging retail prices that cause price squeeze.
Belgium	Other Ex ante as part of the approval of wholesale tariffs. Ex post after the launch of a new retail product that likely will be considered a flagship product. Ex post upon request of complaint from market players. At any time on the initiative by the BIPT. (Principle 15 of BIPT PST guidelines)	Unspecified	Adjustment of retail and/or wholesale prices at the discretion of the operator. (Principle 15 of BIPT PST guidelines)
Croatia	Before launch of retail offer 8 working days before Reduced from previously applicable 45 days by HAKOM decision of Dec. 7, 2015.	Tacit approval No deadline	Adjustment of retail and/or wholesale prices HAKOM would issue an obligation for the SMP operator to allow for a sufficient margin, by either increasing the retail price or decreasing the wholesale price. If the SMP operator proceeded to launch the offer, HAKOM would revoke it. HAKOM decision of Jan. 18, 2017 required HT to stop offering bundled offers that do not comply with the updated PST test within 8 days from receiving the decision.
Denmark	After launch of retail offer Every 6 months ERST will identify the flagship products to be covered by the test	Tacit approval Time limit unspecified	Adjustment of retail prices TDC is, however, allowed to lower its prices to meet those of its competitors, even if it results in a price squeeze on flagship products. After the competitors have raised their prices, TDC must adjust its retail prices within 2 months to eliminate price squeeze.
Italy	Before launch of retail offer 30 days before AGCOM can extend the deadline subject to more specific rules.	Tacit approval Within 30 days	Adjustment of retail prices TIM would need to notify a modified retail offer
Latvia	Other Within 12 months after the PST obligation has been imposed on the SMP operator. Within 3 months after the SMP operator has published its access reference offer or changed its access tariffs. Within 3 months after the SMP operator has announced changes to the flagship product or its tariffs. If SPRK wants to check whether or not the operator's access tariffs are cost oriented.	No deadline, operator not required to wait for NRA decision	Adjustment of retail and/or wholesale prices at the discretion of the operator
Netherlands	Before launch of retail offer KPN must do the test before product launch. Every quarter a report has to be sent to ACM. ACM may investigate in case of doubt or complaints.	Tacit approval No deadline, operator not required to wait for NRA decision	Adjustment of retail and/or wholesale prices at the discretion of the operator.
Portugal	Before launch of retail offer Ten days before	No deadline, operator not required to wait for NRA decision	Adjustment of retail and/or wholesale prices The incumbent may choose to adjust retail and/or wholesale prices but in practice adjusted the wholesale price
Slovakia	After launch of retail offer	Tacit approval Time limit unspecified	Adjustment of retail and/or wholesale prices The NRA can revise remedies or regulated prices or market analysis.
Slovenia	Before and after launch of retail offer 14 days before In addition, every year a report has to be sent to AKOS. AKOS may investigate in case of doubt or complaints.	Tacit approval no deadline	Adjustment of retail and/or wholesale prices AKOS may demand that an offer is blocked until wholesale prices are adjusted to allow replicability or the offer is modified.
Turkey	Before launch of retail offer Price squeeze test has to be applied 1 month prior to the launch of all new tariffs. ICTA can apply an ex post test once per year for all current tariffs or whenever a complaint is submitted by other operators.	Explicit NRA decision ICTA must complete the test within 14 days after all necessary documents and data are submitted by the operators. ICTA can extend this period up to 6 weeks if any extra information is required.	Adjustment of retail prices Operators cannot launch their tariffs before passing the price squeeze tests of ICTA.

Rasti i Norvegjisë për testin ERT në tregun me shumicë të akses/orgjinimit në rrjetet celulare

Norvegjia aplikon testin margin squeeze si në tregun e telefonisë fikse për aksesin broadband ashtu edhe në atë mobile për thirrjet zanore dhe aksesin broadband, testi kryhet për të gjithë të dhënat e portofolit të produktit përkatës dhe për secilin imput të shitjeve me shumicë në mënyrë të ndarë. Testi ERT është vendosur nga rregullatori Nkom si masë rregullatore në tregun me shumicë të akses/origjinimit në rrjetet celulare (tregu 15 i rekomandimit të vitit 2003 të KE) për operatorin me FNT Telenor më 1 Korrik 2016. Testi i aplikuar nga Nkom është “*adjusted equally efficient operator*” (adjusted EEO): testi fillon me kostot e operatorit me FNT dhe më pas korrektohet për madhësinë e një operatori gjenerik (alternativ). Për llogaritjen e kostove të rrjedhes se poshtme (retail, marketing, billing...), Nkom përdor metodën e kostove totale (Tregu 15/2003). Testi MS i aplikuar nga Enkom nuk e ka të specifikuar vlerësimin e komponentëve/elementëve të parregulluar të paketave bundle.

Për sa i përket periodicitetit të kryerjes së testit MS Nkom e kryen atë pas hedhjes në treg të ofertës në tregun e pakicës, ose periudhë 6 muojre. Afati për vendimmarrjen e Nkom normalisht është 30 ditë (afati maksimal sipas parashikimit ligjor është 4 muaj).

Nëse testi MS dështon, Nkom kërkon rregullim të çmimeve të shumicës duke i kërkuar operatorit me FNT të ndryshojë çmimet e shumicës (sipas parashikimeve të Ecom Act paragrafi 10-6). Gjithashtu, Enkom mund të vendosë edhe masa administrative, rimbursim ose masa detyruese (para 10-3, 10-12 and 10-7 of the Ecom Act).

4. Rregullimi i tarifave me shumicë të aksesit dhe origjinimit në rrjetin Vodafone Albania

4.1. Baza ligjore dhe Problemet e identifikuar nga Analiza 2018

Sic është cituar në kapitullin 2 të këtij dokumenti, objektivi i rregullimit të tarifave është që, së bashku me masat e tjera rregulltaore, të adresojë problemet e identifikuar nga analiza e tregut.

Në Nenin 53 përcaktohet se Qëllimi i rregullimit të tarifave është parandalimi i sjelljeve antikonkurruese dhe i diskriminimit të përdoruesve fundorë dhe konkurruesve në treg që mund të rezultojnë nga veprimet e sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg për tarifën. Masat për rregullimin e tarifave duhet të jenë të bashkërenduara dhe proporcionale në relacion për rregullimin e përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji

Sipas nenit 56 “Nëse nga analiza e tregut të kryer, në përputhje me nenin 34 të këtij ligji, për tregun përkatës për përdoruesit fundorë (tregu i pakicës) është arritur në përfundimin se në këtë treg nuk ka konkurrencë efektive dhe nëse masat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni nuk janë të mjaftueshme, AKEP-i ka të drejtë të vendosë ndaj sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg detyrime të veçanta sipas shkronjave “a” ose “b” të kësaj pike:

a) detyrimet e veçanta përfshijnë kërkesat që sipërmarrësi:

i) të mos zbatojë tarifa tepër të larta;

ii) të mos pengojë hyrjen në treg të lojtarëve të rinj;

iii) të mos kufizojë konkurrencën, nëpërmjet zbatimit të tarifave të larta të paarsyeshme ose tarifave të ulëta të paarsyeshme;

iv) të mos shfaqë parapëlqime të diferencuara ndaj përdoruesve fundorë të veçantë;

v) të mos ofrojë paketa të paarsyeshme shërbimesh;

b) detyrimin për nxjerrjen e vendimit përkatës për rregullimin e tarifave, sipas nenit 57 të këtij ligji”.

Sipas nenit 57, AKEP-i zbaton rregullimin e tarifave nëpërmjet metodave të mëposhtme:

a) përcaktimit të nivelit minimal ose maksimal të tarifave;

b) korigjimit të ecurisë së tarifave, duke përcaktuar kushte të tilla si:

i. kufirin maksimal të normës së ndryshimit (rritjes/uljes) të mundshëm të tarifës brenda një periudhe të caktuar kohe;

ii. raportin maksimal të rritjes së tarifës, që imponohet nga rritja e çmimeve të elementeve përbërëse (inputeve), brenda një periudhe kohe të caktuar;

iii. procedura, që do të përdoret për përcaktimin ose llogaritjen e tarifës, përfshirë detyrimin për orientimin në kosto, përcaktimin e kostove efiçente, që mundëson realizimin e një fitimi të arsyeshëm;

Në rregullimin e tarifës, bazuar në pikën 1 të këtij neni, AKEP-i vlerëson edhe të dhënat më të fundit për:

a. praktikën më të mirë të vendeve të BE-së;

- b. *tarifat mesatare të vendeve të BE-së;*
- c. *tarifat e vendeve të rajonit me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë; ç) raportet ndërmjet tarifave të shumicës dhe pakicës;*
- d. *normën e fitimit të arsyeshëm, të realizuar nga sipërmarrësit e tjerë të komunikimeve elektronike në vendet e BE-së dhe në vendet me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë.*

Metodat e rregullimit të tarifave mund të jenë të kombinuara.

Përcaktimi i tregut përkatës të akses/origjinimit në rrjetet celulare, është tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare. Tregu përkatës përfshin aksesin dhe origjinimin (thirrjet zanore dalëse) në rrjetet celulare në nivelin e shumicës, aksesin nga kartat me parapagesë dhe kontratë (postpaid), aksesin për rezidentët dhe konsumatorët biznes, origjinimin e SMS dhe shërbimeve të tjera data.

Sipas përfundimeve të analizës së tregut celulare dhe vendimeve të FNT, Vodafone Albania është përcaktuar me FNT në tregun me shumicë të akses/origjinimit dhe ndër detyrimet për FNT, AKEP ka vendosur dhe detyrimin për kontroll të tarifave dhe orientim në kosto (neni 45 i Ligjit 9918). Për këtë detyrim AKEP ka përcaktuar:

- i) Tarifat e aksesit dhe origjinimit të thirrjeve dhe shërbimeve të interkoneksionit të lidhura me këto shërbime në rrjetin Vodafone Albania janë objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP;
- ii) Metoda e rregullimit të tarifave të shërbimeve në piken 'i' më sipër përcaktohet me vendim të veçantë nga AKEP, sipas përcaktimeve të nenit 55 e në vijim të Ligjit 9918.

Në vijim të përcaktimeve të ligjit 9918 dhe rekomandimeve të KE dhe udhëzimeve të BEREC, AKEP, propozon, që detyrimi i kontrollit dhe rregullimit të tarifave në tregun me shumicë të akses/origjinimit për sipërmarrësin me FNT Vodafone Albania, të përfshijë:

1. Rregullimin e tarifave me shumicë të akses/origjinimit të aplikuara nga Vodafone Albania për operatorët MVNO nëpërmjet orientimit në kosto të tyre dhe përcaktimit të nivelit maksimal të tyre (neni 57, pika 1/a);
2. Ndalimin e aplikimit të tarifave të ulëta të paarsyeshme në tregun me pakicë në raport me tarifat me shumicë nëpërmjet aplikimit të testit margin squeeze/ERT (neni 57, pika 1/a dhe 2/ç, dhe neni 56 pika 1).

Rregullimi i mësipërm synon të adresojë problemet e identifikuar në analizën e tregut celular, sidomos problemin e tarifave të ulëta të paarsyeshme të aplikuara në tregun me pakicë, të cilat nuk krijojnë mundësi replikimi ekonomik (me fitim të arsyeshëm) nga operatorët e tjerë në treg apo të mundshëm për të hyrë në tregun me pakicë si MVNO.

4.2. Rregullimi i nivelit maksimal të tarifave me shumicë të akses/origjinimit

Duke ju referuar analizave të mëparshme tregut nga AKEP, rezultatave të emodellit BULRAIC në vitin 2010 si dhe praktikave të tjera ndërkombatëre, kosto e origjinimit të thirrjeve në një rrjet celular (dhe fiks) është pothuajse e barabartë me koston e terminimit të thirrjeve.

Bazuar në vendimin final për MTR, AKEP propozon që nivelet maksimale të tarifave më shumicë të akses/origjinimit në rrjetin Vodafone Albania të jenë sa nivelet e tarifave të terminimit MTR për këtë operator, sipas tabelës së mëposhtëme.

Tabela 8. Niveli maksimal i propozuar për tarifën e origjinimit të thirrjeve në rrjetin Vodafone Albania

	Faza I	Faza II
		1.12.2018
Tarifa maksimale e origjinimit të thirrjeve	1.22	1.11

Shënim: Tarifa në lek/minutë pa TVSH

Sipas nenit 59, sipërmarrësi Vodafone ka detyrimin e për orientimin e tarifave drejt kostos dhe janë të detyruar të provojnë që tarifat e shërbimeve të ofruara prej tyre janë rrjedhojë e kostos eficiente, duke mundësuar një normë fitimi të arsyeshme.

Me kërkesë të AKEP-it, brenda një afati kohor prej 45 ditësh, sipërmarrësit Vodafone Albania duhet të provojnë se tarifat e tij janë të orientuara drejt kostos. Nëse sipërmarrësi, brenda afatit të caktuar, dështon në justifikimin e tarifave si më sipër, AKEP-i konsideron se tarifat nuk janë të orientuara drejt kostos.

Vodafone Albania ndaj të cilëve është vendosur detyrimi për llogaritjen e kostos, të bëjë publikisht të vlefshme përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos, duke treguar të paktën kategoritë kryesore, në të cilat janë grupuar kostot dhe rregullat e përdorura për caktimin e kostove.

Sipas pikës 5 të nenit 59, AKEP, ose një ekspertizë e kualifikuar e pavarur, e përzgjedhur nga AKEP-i, ka të drejtë të kryejë auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë me sistemin e llogaritjes së kostos.

Në lidhje me Shërbimet e aksesit dhe Shërbimet shoqëruese për akses/origjinimin Vodafone Albania duhet të aplikojë tarifat e publikuara në ofertën referencë të interkoneksionit (RIO)...

4.3. Testi Margin Squeeze/ERT për FNT të Vodafone Albania

Propozimet për masat rregulluese përfshijnë edhe propozimin e AKEP për të rregulluar çmimet në tregun e shumicës nëpërmjet aplikimit të testit *margin squeeze (MS)* apo *replikueshmërisë ekonomike (ERT)* për operatorin me FNT Vodafone Albania. Sic është përshkruar në kapitullin 3 të këtij dokumenti aplikimi i këtij testi

Sipërmarrësi i shpallur me FNT do të jetë i detyruar të paraqesë pranë AKEP çdo plan të ri për ndryshim çmimesh, në të cilin duhet të përfshijë një test të thjeshtë nëpërmjet të cilit duhet të demonstroje se plani i ri është rentabël për operatorin me FNT, pra nuk është nën kosto.

Sipërmarrësi Vodafone Albania i shpallur me FNT në këtë treg është i detyruar t'i paraqesë AKEP-it çfarëdo ndryshimi të planit të çmimeve ose planeve të reja dhe të paraqesë me atë plan një test, i cili do të duhej të demonstroje se plani është fitimprurës për sipërmarrësin.

Çdo paketë supozohet të ketë thirrje zanore + SMS + data. Përsa i përket thirrjeve zanore, kostoja e thirrjes, presupozohet të llogaritet sipas formulës: Kosto e origjinimit + tarifë e terminimit + norma e fitimit

Formula për price squeeze për tregun e pakicës(etail):

Formula e përgjithsme për testin ex-ante të MS/ERT për Vodafone Albania do të jetë:

$$RP_{\text{sm}} \geq WC_{\text{reg}} + WC_{\text{non-reg}} + RC.$$

Ku:

- RP_{sm} = Cmimi me pakicë i produktit të operatorit me FNT;
- WC_{reg} = Kostot e inputeve me shumicë nën-rregullim të nevojshme për ofrimin e produktit me pakicë të operatorit me FNT;
- $WC_{\text{non-reg}}$ = Kostot e inputeve me shumicë që nuk janë nën-rregullim të nevojshme për ofrimin e produktit me pakicë (përfshirë kostot e rrjetit të vet);
- RC = Kostot Retail.

Operatori me FNT ka detyrimin që të vërtetojë që tarifat me pakicë plotësojnë kushtin e mësipërm.

Për këtë qëllim operatori duhet të sjellë propozimin tek AKEP, që përmban detaje të sasisë së pritshme që do shiten nga paketa në kohë, koha minimale për përdorimin nga përdoruesi etj., dhe këto duhet të jenë të ndara në periudha. Më pas kryhet skontimi në kohë i këtyre të ardhurave për të arritur në Vlerën Prezente Neto (Net Present Value të Discounted Cash Floë) të pritshëm nga paketa dhe kjo krahasohet me koston me shumicë të paketës..

Për çdo pakete (bundle) si dhe për çmimet e tarifave standard me pakicë e operatorit me FNT duhet të të jetë të pakën sa kostoja me shumicë e elementëve përbërës të pakteës/shportës.

Gjithsesi, procesi i justifikimit me koston është një proces i gjatë dhe operatori ka edhe detyrim për ndarje llogarish(Account Separation). Kjo do të çonte në ngrirje të procesit dhe bllokim të operatorit me FNT deri në llogaritjen e kostove dhe auditimin e tyre nga rregullatori (proces që zgjat dhe mbi një vit). Për të shmangur këto vonesa dhe për ta bërë procesin më fleksibël, pra që detyrimi në tregjet e pakicës të mos jetë barrë e rëndë e pajustificuar, mund të përdoren vlera referencë për elementët e kostove me shumicë.

- *Kosto me shumicë e thirrjeve kombëtare(Wholesale cost of voice (national call))*

Kosto mesatare e një thirrje dalëse kombëtare drejt celularëve = ((proporcioni i thirrjeve on-net të sipërmarrësit (MNO)x2xPureLRIC) + (proporcioni i thirrjeve off-net të MNO)x(PureLRIC + MTR që paguhet për off-net).

Për Vodafone për Fazën I te MTR te propozuar kjo kosto është 2.23 lek/Minute (pa TVSH).

(Burimi: AKEP, MTR 2018)

Kjo vlere mund te përdoret për paketat për thirrjet kombëtare, ndërsa për thirrjet ndërkombëtare duhet te merret MTR i Vodafone + WAVG e MTR te operatoreve te huaj. Do te behet mesatare e ponderuar e tarifave te destinacioneve kryesore sipas trafikut. Për këtë Vodafone duhet te depozitoje ne AKEP te dhëna për trafikun dalës ndërkombëtare dhe MTR përkatëse drejt 10 vendeve kryesore dhe te pjesës tjetër te botës.

- Kosto e shumicës për SMS

Për këtë mund te përdoret vlere 0.7 lek/SMS që është kostoja e SMS-ve sipas rezultateve te modelit BULRAIC+ i vitit 2010

- Kosto e shumicës për data

Në lidhje me këtë shërbim nuk ka të dhëna referencë për koston për 1 MB apo 1 GB dhe në vende të tjera, pasi është një shërbim që nuk ka qenë dhe nuk është nën rregullim. Për këtë shërbim, AKEP gjykon të marrë si tarifë referencë tarifën me pakicë të aplikuar nga Vodafone për 1 GB internet si *add on* (aktualisht 300 lek/GB).

- + koston e pakicës së një operatori të supozuar eficient

Kjo mund të thjeshtohet duke shtuar një shtesë (mark up) mbi kostot me shumicë, p.sh deri në 20%.

- + uljet ose ofertat falas (value of discounts or free offers)

Kjo metodologji mund të jetë më komplekse dhe aplikohet me modelin e përshkruar më sipër të të ardhurave.

Thjeshtëzimi i testit MS

Si përfundim, një test që mund te aplikohet me shpejt dhe të mos përbëjë barrë të rëndë për një paketë me X minuta, Y SMS dhe Z GB:

$$Rp \geq 2.68 X + 0.7Y + 150 Z \text{ (çmimet me TVSH)}$$

Pra, çmimi me pakicë duhet të jetë të paktën sa kostoja me shumicë (voice/SMS/Data) + Kostot e shitjes me pakicë të një operatori eficient/operatorit me FNT + Vlera e skontove/bonuseve/të përfshira në promocione.

Megjithëse përdorimi real i minutave në paketa është shumë më i ulët se ato të përfshira në pagesën fikse, AKEP në aplikimin e testit propozon marrjen në konsideratë të minutave dhe njësive të tjera (SMS dhe Internet) nominale të paketës dhe jo përdorimin real të tyre, pasi kjo të kërkonte aplikim ex-post apo ex-ante por me model DCF, duke rritur dhe kompleksitetin e testit. Gjithsesi edhe aplikimi i testit për Vodafone Average User (viti 2017) tregon se kostot me shumicë janë rreth 50% më të larta se çfarë kanë paguar realisht përdoruesit me pakicë, pra ofrimi në retail është nën-kosto.

Efekti i pritshëm

Nëpërmjet aplikimit të testit MS, AKEP pret që Vodafone te korrektojë paketat duke bërë një reduktim të njësive të përfshiatr në paketa, pasi aktualisht ato janë jo të arsyeshme. Vodafone ka mundësinë që këtë ta shoqërojë me ndryshim të mënyrës së tarifimit të njësive në paketa p.sh nga blloqe me 1 minute apo 60+60 sekonda në tarifim për sekondë, dhe kjo të ishte një masë që do rriste dhe transparencën e përdorimit paketave.

Aneks 1: Testi Margin Squeeze/ERT

1. Formula

$$R_{\text{Pmp}} \geq W_{\text{Creg}} + W_{\text{Cnon-reg}} + RC$$

$$R_p \geq W_C X + W_{\text{SMS}} Y + W_{\text{MB}} Z (\text{çmimet me TVSH}) + RC$$

Ku:

R_p: Retail price

W_C: Kosto me shumicë e thirrjeve kombëtare (e rregulluar)= 2.92...varet nga vendimi per MTR

X: Sasia e minutave të përfshira në paketë

W_{SMS}: Kosto me shumicë e SMS (e rregulluar: BULRAIc 2010)=0.7

Y: sasia e SMS te përfshira ne pakete

W_{MB} : Kosto me shumicë e Internetit celular (e parregulluar). Reference retail minus=100-150

Z: sasia në GB e përfshirë në paketë

RC: Kosto retail (pranohet dhe zero??)

2. Paketat tarifore objekt i testit

Flagship tariff plans:

Main Prepaid (30 ditore, javore..)

Info nga Vodafone per te ardhurat/trafiku sipas paketave

Paketat e reja

Paketat ekzistuese: afat per axhustim

3. Afati i njoftimit

Minimumi 30 ditë para hyrjes në fuqi

4. Aplikimi i testit: çfare ndodh nese deshton?

Nëse testi dështon Operatori me FNT duhet:

- të korrektojë/ndryshojë tarifën/përbërjen e paketës retail, dhe/ose
- korrektojë tarifatat me shumicë nën-rregullim (MTR) dhe tarifën/paketën me pakicë.

Aneks 2-Pyetjet e konsultimit publik

1. Çfarë mendoni lidhur me propozimin e AKEP për barazimin e tarifave të origjinimit me tarifën e terminimit?
2. Çfarë mendoni për uljen graduale të tarifave të origjinimit në të njëjtin trend me glide –path e propozuar në konsultimin publik të tarifave të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare?
3. Komentet tuaja lidhur testin e margin squeeze për rregullimin e tarifave të aksesit dhe origjinimit për dy operatorët me Fuqi të ndjeshme në këtë treg. Nëse mendoni për teste më adekuate lutem komentoni?
4. Cila mendoni se është metoda më e përshtatshme për përzgjedhjen e paketave që do ti nënshtrohen testit?
5. Komentet tuaja për koeficientët e kostove me shumicë sipas formulës së propozuar?
6. Cilat janë kostot kryesore të pakicës për produktet/shërbimet e ofruara?